



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KESHILLI I QARKUT KORÇE**

**RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMITTE BUXTETIT TE VITIT 2018**  
**PER PERIUDHEN VJETORE**

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit te buxhetit vendor” paraqitim Këshillit të Qarkut “Raportin për monitorimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2018 për periudhën vjetore”

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit te Këshillit te Qarkut për vitin 2018 eshte bere ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi si me poshte:

- *Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*
- *Ligjin nr.68 /2017“Per financat e vetqeverisjes vendore”*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008“ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.*
- *Ligjin nr 11/2017“ Për buxhetin e vitit 2018” neni 16.*
- *UdhëzimeMinistrisë të Financave është datë 20.03.2018.“Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”*
- *UdhëziminplotësueseMinistrisëtëFinancave është datë 19.01.2018 “Përbatimin e buxhetitëve të vitit 2018”.*
- *Ne Vendimin e Keshillit të Qarkut nr.13 date 18.12.2017 “Per miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut per vitin 2018”*

Raporti paraqet punëne administratës të Këshillit të Qarkut Korçë në zbatimin e politikave të percaktuara nga Keshilli i Qarkut si në realizimin e burimeve te te ardhurave ashtu edhe ne menaxhimin e shpenzimeve, per një ritje te cilesise te sherbimeve te ofruara. Ai përqëndrohet kryesisht në veprimet e ndërmarra dhe arritjet në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, si dhe në menaxhimin dhe administrimin sa më të mirë të shpenzimeve për periudhën vjetore 2018.

**CILI ËSHTË MISIONI I QARKUT KORCE**

Misioni i Këshillit të Qarkut Korçështë hartimi dhe zbatimi i politikave raxonale, harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore në plotësim të funksioneve të veta ligjore, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj. Këshilli i Qarkut ofron bashkëpunimin dhe koordinimin midis qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore, si dhe bashkëpunimin e kordinimin e politikave midis njesive të qeverisjes vendore te rajonit.

Këshilli i Qarkut Korce ofron partneritet, koordinim dhe mirëkuptim midis të gjithë partnereve lokale e rajonale per pjesemarje në projekte gjithpërfsirëse. Keshilli i Qarkut ofron partneritetin e tij per pjesemarje ne Programet nderkufitare te financaura nga Bashkimi Europiane, etj.me synim zhvillimin ekonomiko social te Rajonit dhe ritjen e cilesise se sherbimeve per komunitetin.

### ***OBJEKTIVAT E KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2018***

Disa nga objektivat kryesore te Keshillit te Qarkut per vitin 2018:

- *Hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore.*
- *Hartimi i Planit Sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Korce.*
- *Pjesemarja ne Programet nderkufitare e me gjere dhe krijimi i partneriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.*
- *Nxitjen e bashkëpunimit midis njesive te qeverisjes vendore te Rajonit, si dhe bashkëpunimin nderrajonal.*
- *Permiresimi i shërbimeve të ofruara komunitetit dhe sigurimi i një qeverisje më të mire.*
- *Përmiresimi i rolit të Qarkut dhe njësive përbërëse të tij, në procesin e Integrimit European.*

### ***REALIZIMI I BUXHETIT TE KESHILLIT TE QARKUT PER PERIUDHEN VJETORE 2018***

Zbatimi i Buxhetit te Keshillit te Qarkut per periudhen vjetore 2018 ka ecur ne kushte normale, kjo si rezultat i nje planifikimi te mbeshtetur mbi burime reale te te ardhurave te vete Institucionit si dhe nje menaxhim te mire te shpenzimeve ne funksion te realizimit te aktiviteve dhe programeve te planifikuara per kete vit.

#### ***Burimet e financimit :***

- Të ardhurat e vetë Institucionit
- Transferta e Pakushtëzuar (Granti)
- Transferta e Kushtëzuar

#### ***Funkzionet kryesore të strukturave financiare :***

- Për funksionet e veta
- Për funksionet e përbashkëta
- Për funksionet e deleguara

#### ***➤ Analiza e realizimit te te ardhurave per periudhen vjetore 2018***

Të ardhurat e veta per vitin 2018 jane parashikuar sipas metodës dinamike duke marrë ne konsiderate të dhënat e ecurisë së arkëtimeve të viteve të fundit, dhe realizimit faktik të vitit 2017.

***Llojet e të ardhurave që ka arkëtuar institucioni gjatë vitit 2018 kanë qenë si mëposhtë:***

- Të ardhura nga tarifat e ndryshme që institucioni ka të përcaktuara me akte ligjore dhe me vendime të Këshillit të Qarkut ne funksion te sherbimeve qe ai i ofron komunitetit.
- Të ardhurat nga derdhja e kontributave financiare nga bashkiteperberese te Qarkut, te cilat jane detyrim ligjor i tyre ne zbatim te Ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”.
- Të ardhurat e trashëguara nga viti buxhetor 2017, të cilat janë planifikuar te perdoren per financimin e shpenzimeve te planifikuar per kete vit buxhetor

Gjate kesaj periudhe Institucioni përgjithësisht ka ecur drejt përbushjes së objektivave dhe parashikimeve të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut duke patur parasysh një balance te drejtë midis burimeve te financimit dhe realizimit te shpenzimeve ne përbushje te aktiviteteve dhe programeve te miratuara per vitin 2018.

#### **Te ardhuratne buxhetin e Keshillit te Qarkut per kete periudhe jane realizuar si me poshte:**

ne 000/leke

Te ardhurat	Plani viti 2018	Plani 2018	Fakti 2018	Realizim ne %
1. Transferta e pakushtezuar	49490	49490	49490	100
2. Te ardhurat e veta	7800	7800	1435	18.4
a. Te ardhura nga tarifat	1800	1800	735	40.8
b. Kontributi finanziar i bashkive	6000	6000	700	11.7
3. Te ardhura te trasheguara 2017	57527	57527	57527	100
4. Transferta e kushtezuar	6770	6770	6770	100
<b>Totali 8/mujor</b>	<b>121587</b>	<b>121587</b>	<b>116657</b>	<b>95.9</b>

Transferta e pakushtezuar vazhdon te jete burimi kryesor i te ardhurave dhe eshte perdorur per financimin e funksioneve te veta ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi.

Realizimi i te ardhurave te vete institucionit vazhdon te jete ne nivele te ulta, kjo lidhet me faktin se si ato planifikohen. Te ardhurat nga tarifat per periudhen vjetore jane realizuar ne nivelin **735 mijë leke** nga **1800 mijë leke** te planifikara ose **40.8 %**. Planifikimi i tyre eshte bere mbi bazen e realizimit faktik per periudhat paraardhese. Konkretisht per vitin 2017 realizimi i te ardhurave nga tarifat per te njejtën periudhe kane qene **1131 mijë leke**. Realizimi i ketij treguesi nuk lidhet me punen e institucionit por me ate nivel sherbimesh qe kerkohet nga ana e komunitetit. Kryesisht keto te ardhura realizohen nga Drejtoria e DAMT ne qark. Te ardhurat nga tarifat e sherbimeve ne transport jane ne nivelin zero pasi keto kopetenca i kane kaluar bashkive.

Vazhdon te mbetet problem realizimi i te ardhurave nga kontributi financier qe bashkite duhet te derdhin ne buxhetin e Keshillit te Qarkut. Theksojme se ky kontribut eshte burimi kryesor i te ardhurave te vete institucioni. Planifikimi i ketij kontributi behet nga vete bashkite dhe miratohet ne buxhetin e tyre. Pavaresisht nivelit te ulet te planifikimit te ketij treguesi, nga ana e bashkive nuk behet ne menyre periodike derdhja e ketij kontributi ne buxhetin e Keshillit te Qarkut. Per periudhen 2018 realizimi i tij eshte ne nivelin **11.7% ose 700 mijë leke**, nga te cilat 600 mijë leke te ardhura te derdhura nga Bashkia Korce dhe 100 mijë leke nga Bashkia Maliq. Krahasuar me vitin 2017 kemi nje ritje **100 %** te ketij treguesi. Per vitin 2017 vetem Bashkia Maliq ka derdhur **300 mijë leke**. Megjithate ky tregues eshte ne nivele te ulta duke patur parasysh realizimin e te ardhurave te vete bashkive. Mendojme se duhet te kete nje permiresim me akte ligjore per te bere te mundur detyrimin ligjor te bashkive ne derdhjen e kontributit financier per llogari te Keshillit te Qarkut.

Te ardhurat e trasheguara nga viti 2017 ne vlere **57527 mijë leke** (grant + te ardhura) jane ne nivele te larta dhe kapin rrëth **47.3 %** te buxhetit total. Kjo vlere eshte krijuar gjate dy viteve te fundit, pasi Institucioni ka planifikuar fonde te mjaftueshme per financimet e 15 % te pjesemtarjes ne buxhetet e

Projekteve te fituara nga Programet IPA CBC 2014-2020. Implementimi i ketyre projekteve filloj gjate vitit 2018 dhe financimi i tyre do te vazhdoje ne dy vitet e ardhshme.

*Te ardhurat e realizuara ne total jane perdorur per financimin e funksioneve te veta te percaktuara si me poshte:*

- *Pagat e personelit,*
- *Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit.*
- *Për shpenzime operative*
- *Investime*
- *Bashkefinancim Projekte te BE*
- *Investimene infrastruktura sipas propozimeve te bashkive dhe miratimit ne Keshillin e Qarkut*

### **Te ardhura nga fonde e kushteuara per periudhen vjetore 2018**

Gjatë vitit 2018, Këshilli i Qarkut për përbushjen e funksioneve të deleguara, ka përfituar nga buxheti i shtetit fonde të kushteuara, buxhetore për shpenzime në shumën prej **6840 mijë lekë**. Keto fonde janë perdorur per financimin e aktivitetit te Drejtorese se Administrimit dhe Mbrojtjes ne Qark e cila eshte funksion i deleguar. Ky akordim është kryer në mbështetje të programit fillestar të buxhetit te shtetit.

#### **➤ Analiza e realizimit te shpenzimeve per periudhen vjetore 2018**

Shpenzimet e buxhetit gjatë vitit 2018 janë realizuar në shumën prej **41472 mijë lekë** ose e shprehur në përqindje **36.4 %** ndaj programimit vjetor prej **113856 mijë leke**.

Nga totali i shpenzimeve per periudhen 2018, shpenzimet korrente janë realizuar në shumën prej **41403 mijë leke ose 81.7%** ndaj planit prej **50657 mijë leke** sipas programeve te miratuara per administraten e keshillit te qarkut dhe drejtorene e DAMT ne qark. Shpenzimet kapitale për vitin 2018 janë ne nivelin zero pasi financimi i tyre do te behet ne vitin 2019 sipas parashikimeve ne kontratat e lidhura perkatesisht per cdo objekt. Gjithashtu investimet e vete institucionit lidhen me levizjen e institucionit ne ambjenjtet e reja qe do te ndodhe ne kete periudhe aktuale. Shpenzimet per pjesemarje ne programet e Bashkimit European janë realizuar vetem 69 mijë leke nga 45.5 milion leke te planifikuar. Kjo lidhet me fillimin e implemantimit te kater projekteve te fituara vetem ne 6/mujorin e dyte te vitit 2018. Financimi i tyre sipas programeve perkatese do te filloj ne vitin 2019 dhe do te vazhdoje ne dy vitet e ardhshme.

### **Realizimi i Shpenzimeve per vitin 2018 paraqiten si me poshte**

**Ne 000/leke**

Nr.	Emertimi sipas Programeve	Plan	Fakt	Diferenca	% realizim
1	Administrata – Programi 01110	61124	35093	26031	57.4
	Paga personeli	16790	14246	2544	84.8
	Sigurime shoqërore e shëndetsore	3160	2617	543	82.8

	Shpenzime operative, keshilltare e vendime gjyqesore	20447	14894	5553	72.8
	Transferta korente te brendshme	3420	3336	84	97.5
	Nga keto:				
	- Bashkia Korce Projekti “Qendra ditore per moshen e trete”	2000	2000	0	100
	- Shoqatat e te verberve	870	786	84	90.3
	- Sherbimi i Kujdesit Paliativ Korce	400	400	0	100
	- Qendra Rezidenciale Zhvillimit Korce	150	150	0	100
	Investime kapitale	17307	0	17307	0
	Nga keto:				
	Investime te institucionit	2840	0	2840	0
	Investime ne infrastrukture per bashkite e qarkut	14467	0	14467	0
<b>2</b>	<b>Drejt.DAMT –Programi 01160</b>	<b>6840</b>	<b>6310</b>	<b>530</b>	<b>92.3</b>
	Paga personeli	5500	5012	488	91.1
	Sigurime shoqerore e shendetsore	870	837	33	96.2
	Shpenzime operative	400	391	9	97.8
	Shperblim fond vecante per pension	70	70	0	100
<b>3</b>	<b>Bashkefinancim ne Projekte me fonde Bashkimit European- Programi 08250</b>	<b>45542</b>	<b>69</b>	<b>45473</b>	<b>0.15</b>
<b>4</b>	<b>Fondi rezerve – Programi 04980</b>	<b>350</b>	<b>0</b>	<b>350</b>	<b>0</b>
	<b>Total KESHILLI I QARKUT</b>	<b>113856</b>	<b>41472</b>	<b>72384</b>	<b>36.4</b>

#### Analiza analitike e shpenzimeve për vitin 2018, (për Administratën)

Buxheti i periudhes 2018 per administraten e Keshillit te Qarkut eshte realizuar ne nivelin **57.4 %** dhe ne vlerë absolute **35093 mijë leke** nga **61124 mijë leke** te programuara. Menaxhimi i buxhetit per kete periudhe eshte bere sipas programeve te miratuara ne planin fillestar dhe ndryshimet perkatese, duke ruajtur nje raport te drejte ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe duke patur nje bilanc pozitiv te pagesave brenda limiteve te miratuara nga Keshilli i Qarkut.

Duke analizuar në mënyrë analitike sipas strukturave përdorimi i fondeve për shpenzime që ka patur në dispozicion administrata e Këshillit të qarkut gjatë vitit 2018 rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet Korente per Administraten jane realizuar ne nivelin 35093 mijë leke ose 80.1 % ndaj 43817 mijë leke sipas programit buxhetor. Ecuria e shpenzimeve korente ka qene ne perpjestim te drejte per cdo muaj duke perm bushur te gjitha nevojat dhe detyrimet per funksionimin normal te Administrates. Mosrealizimi eshte kryesisht ne shpenzimet per vendime gjyqesore dhe detyrime te trasheguara per shkak edhe te vendosjes se limitit te perdonimit te cashit ne 2 mujorin e fundit. Financimi i tyre po vazhdon ne vitin aktual.
- Shpenzimet kapitale jane ne nivelin zero per aresyet qe permendem me lart.

##### a. *Shpenzime për Pagat dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600+601)*

Realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore per vitin 2018 për personelin është kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Këshilli i Qarkut. Administrata perbehet nga 13 punonjës, te cilet paguhën me nivelin e pagave te miratuara ne Keshillin e Qarkut. Fondet per financimin e ketyre shpenzimeve jane nga Transferta e Pakushtëzuar e vitit 2018 si dhe pjeserisht nga te ardhurat e trasheguara. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për vitin 2018 eshte ne vleren **16863 mijë leke ose 84.5 %**ndaj **19950 mijë leke** te miratuara sipas programit. Ne kete mosrealizim ka ndikuar perfundimi parakohe i pageses ne listen e pritjes per një punonjese si dhe mosperdorimi i fondit te vecante te miratuar per kete periudhe.

#### *b. Shpenzimet Operative, keshilltare dhe vendime gjyqesore (Artikulli 602)*

Realizimi i shpenzimeve operative, keshilltare dhe vendime gjyqesore per kete eshte bere ne mbeshtetje te programeve dhe aktiviteteve te miratuara ne Keshillin e Qarkut. Niveli i realizimit te ketyre shpenzimeve eshte 14894 mijë leke ose 72.84 % ndaj 20447 mijë leke te miratuara. Nga analiza niveli i shpenzimeve rezulton si me poshte:

- Shpenzime per blerje kancelari, tonera, dokumentacion etj art. 6020 Jane realizuar ne nivelin 358 mijë leke
- Shpenzime per energji, uje telefona fix e celulare e shpenzime postare Art. 602.2 Jane realizuar ne nivelin 628 mijë leke
- Shpenzime per karburant, riparim auto dhe siguarcione te mjeteve Art. 6023 Jane realizuar ne nivelin 1720 mijë leke
- Shpenzimet per udhetim e dieta Art. 6024 Jane realizuar ne nivelin 2912 mijë leke
- Shpenzimet per riparim e mirembajtje te pajisjeve te zyrave Art. 6025 Jane realizuar ne nivelin 90 mijë leke
- Shpenzime per pagesa te vendimeve gjyqesore Art. 6027 Jane realizuar ne nivelin 5941 mijë leke
- Shpenzime per pagesen e shperblimit per anetaret e Kryesise te Keshillit te Qarkut Art. 6029 Jane realizuar ne nivelin 1092 mijë leke
- Shpenzime te tjera operative, si aktivitete, pritje te huaj, kuota anetaresimi ne Shoqaten e Keshillave te Qarqeve dhe AER ( Asambleja Europiane e Rajoneve ) Art. 6029 Jane realizuar ne nivelin 1470 mijë leke

Te gjitha shpenzimet jane bere sipas programit buxhetor te miratuar ne Keshillin e Qarkut per vitin 2018. Gjithashtu gjate kesaj periudhe jane likujduar edhe detyrime te trashguara nga periudhat e kaluara duke ulur borxhin me 4678 mijë leke. Likujdimi i detyrimeve eshte bere edhe kundrejt amortizimit te tyre te parashikuar ne Programin Buxhetor Afatmesem 2019-2021, si dhe ne Vendimin e Keshillit te Qarkut nr. 13 date 18.12.2017 "Per miratimin e buxhetit te Keshillit te Qarkut per vitin 2018".

#### *c. Shpenzimet për Pagesat e Transfertave të Brendshme (Artikulli 604)*

Në këtë artikull përfshihen shpenzimet e planifikuara për transfertat e brendshme siç janë ato të Shoqatave të Verbërve të Qarkut Korce, kontribut finanziar per Qendren e Sherbimit Paliativ Korce, kontribut finanziar per Qendren Rezidenciale te Zhvillimit Korce si dhe pjesemarje ne Projektin e perbashket me Bashkine Korce " Qendra ditore te moshes se trete". Per kete periudhe realizimi i ketij artikulli eshte ne nivelin **3336 mijë leke ose 97.5% te 3420 mijë leke** te programuara sipas zerave:

- Kontributi financiar per Shoqatat e te Verberve te Rajonit te Korce eshte realizuar ne nivelin 786 mijë leke kundrejt vleres prej 870 mijë leke te programuara ( detyrime te trasheguara nga viti 2017 dhe plan 2018)
- Kontributi financiar per Qendren e Kujdesit Paliativ Korce eshte realizuar 100 % ose 400 mijë leke te programuara.
- Pjesemarja ne projektin e perbashket me Bashkine Korce “Qendra ditore te moshes te trete” eshte realizuar 100 % ose 2000 mijë leke te programuara.
- Kontributi financiar per Qendren Rezidenciale te Zhvillimit Korce ne masen 150 mijë leke sipas miratimit ne Keshillin e Qarkut.

*d. Shpenzimet Kapitale Investimet (Artikulli 230-231)*

Për vitin 2018 Programi i investimeve i miratuar me Vendim te Keshillit te Qarkut eshte **17307 mijë leke**, por realizimi i tij eshte ne nivelin zero. Kjo situate lidhet fillimin e punimeve ne objektet e prokuruar ne tremujorin e fundit te vitit 2018 dhe financimi i tyre do te behet ne vitin 2019 sipas percaktimit te bere ne kontratat perkatese.

*Burimet e Financimit për Programin e Investimeve jane :*

- Nga Transferta e Pakushtëzuar
- Nga të Ardhurat e veta, Tarifat Vendore

Per vitin 2018 Keshilli i Qarkut u prokuruan kater objekte ne Investime ne infrastrukturre ne bashkite e Qarkut me objekte si me poshte:

- Nderhyrje pjesore ne infrastrukturen rrugore ne fshatrat Ravnik dhe Floq, Bashkia Korce me vlere 2500 mijë leke
- Rigjenerim i hapesirave mes pallateve Bilisht, bashkia devoll me vlere 2825 mijë leke
- Rehabilitimi i shkolles 9/vjecare Plase, bashkia Maliq me vlere 4028 mijë leke
- Rikonstrukcion catia e cerdhes se femijeve qytetin Erseke, bashkia Erseke me vlere 2436 mijë leke

Ne programin e investimeve per vitin 2018 jane planifikuar edhe investime per vete institucioni, realizimi i te cilave lidhet me kalimin e institucionit ne ambjentet e reja.

I gjithe fondi i paperdorur per investime ne vitin 2018 i eshte bashkangjitur buxhetit te vitit 2019.

**Analiza analitike e shpenzimeve për vitin 2018 per funksionet e deleguara ( DAMT ne qark )**

Keshilli i qarkut ne permbushje te funksioneve te deleguara si funksioni i Drejtorisë te Administrimit dhe Mbrojtjes te Tokes ne qark, ka te programuar ne Buxhetin e tij edhe fonde nga transferta e kushtezuar, te cilat delegohen nga Buxheti i Shtetit.

Gjatë vitit 2018, shpenzimet e përgjithshme për funksionimin e Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), janë realizuar në shumën prej **6310 mijë lekë**, ndaj programit vjetor prej **6840 mijë lekë** ose e shprehur në përqindje në **92.3 %**.

Ky buxhet paraqitet përgjithësisht i realizuar në të gjitha zërat e shpenzimeve, fondi pagave dhe sigurimeve shoqërore parashikuar me rezerva.

**a. Shpenzime për Pagat dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600+601)**

Realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore per vitin 2018, për punonjësit e Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), janë kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Ministria e linjës si dhe nivelit te pagave te miratuara me Vendim te Keshillit te Ministrave.

Për vitin 2018, numri i punonjesve per kete drejtori eshte 7. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore eshte ne vleren **5849 mijë lekë**, kundrejt fondit të programuar ne vlerë **6370 mijë leke** ose e shprehur në përqindje në **92 %**. Kjo lidhet me një planifikim me rezerve, si dhe kalimit ne pagese nga sigurimet shoqërore per një punonje ne 2/mujorin e fundit. Fondet e paperdorura per kete program nuk trashegohen ne vitin pasardhes.

**b. Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (Artikulli 602)**

Per periudhen 2018 vlera e shpenzimeve operative eshte planifikuar 400 mijë leke dhe realizimi i tyre eshte ne nivelin 97.75 % ose 391 mijë leke.

**Realizimi i buxhetit te Keshillit te Qarkut per pjesemarje ne Programe nderkombetare**


Per periudhen 2018 ne Programin buxhetor te Keshillit te Qarkut eshte planifikuar buxhet per financimin e projekteve me fonde nga Bashkimi European. Keshilli i Qarkut ne zbatim te funksioneve te percaktuara me akte ligjore e nenligjore ka mare pjese gjeresisht ne aplikimet per projekte sipas Programeve te bashkepunimit nderkuftar IPA CBC si dhe ne Programe te tjera nderkuftare. Aktualisht jane finalizuar 4 projekte me një vlerë totale prej rreth 1050 mijë euro si me poshte:

- Save – Water me vlere	802594.00 euro
- Waste Rreact me vlere	93967.59 euro
- Wincome me vlere	61773.66 euro
- SaveSafe Water me vlere	52951.02 euro

Per keto projekte jane nenshkruar kontratat me partneret dhe ka filluar implementimi i tyre. Per kete qellim ne Buxhetin e Keshillit te Qarkut per periudhen 2018 jane planifikuar 45542 mijë leke fonde per bashkefinancim. Realizimi i tyre eshte ne nivelin zero per shkak se financimi i tyre do te filloje ne vitin 2019 dhe ne vazhdim sipas percaktiveve ne kontratat perkatese.

Kryetar i Keshillit te Qarkut

Ana VERUSHI



KESHILLI I QARKUT KORCE  
ANEKS nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

Per periudhen vjetore 2018

ne 000/lake

Emri i Grupit	Kodli i Grupit					
Shpenzimet e Njësisë së Vjetëqeverisjes Vendore						
Programet	(1) Fakti i viti paraardhes	(2) PBA Viti 2018	(3) Buxheti Vjetor Plan Filletar Viti 2018	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2018	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes progresive vjetori 2018	(6) Fakti i periudhes progresive vjetori 2018
Titulli	Emertimi					Diferencia
01110	Administrata e Keshillit të Qarkut	25,876.0	37,969.0	51,316.0	61,124.0	35,093.0
01160	Drejtoria e AMT ne qark	6,499.0	7,058.0	6,770.0	6,840.0	6,310.0
08250	Bashkëfinancim ne Programme të BE	91.0	19,421.0	37,122.0	45,542.0	69.0
04980	Fondi Rezerve	0.0	1,500.0	500.0	350.0	0.0
0005	Programi 5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
.....	.....					
Totali i Shpenzimeve të Njësisë		32,466.0	65,948.0	95,778.0	113,856.0	41,472.0
Totali		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0

Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	Ana VERUSHI
	Firma	
	Data	13.03.2018

**KESHILLI I QARKUT KORCE**

**Anekzi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujive**

**Per periudhen vjetore 2018**

ne 000/lake

Këshilli Qarkut Programi	KORCE 01110	Art.	Emertimi	-1	-2	-3	-4	-5	Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	(7)=(6)-(5) Diferencia
				Fakti i viti parëdhes	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Kodi i Programit 01110	
600	Paga	13581	Viti 2017	Plan 2018	Viti 2018	Plan Filletar Viti 2018	Plan i Rishkuar Viti 2018	Periodhes/progresiv vjetori 2018	Fakti Periodhes/progresiv vjetori 2018	(7)=(6)-(5) Diferencia
601	Sigurime Shqetësore	2267		2930	3160	3160	3160	16790	16790	(7)=(6)-(5) Diferencia
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	9694		15709	18446	20447	20447	14894	14246	(7)=(6)-(5) Diferencia
603	Subvençione	0		0	0	0	0	0	2544	(7)=(6)-(5) Diferencia
604	Transfera Korente të Brendshme	334		800	3420	3420	3420	3336	2617	(7)=(6)-(5) Diferencia
605	Transfera Korente të Huaja	0		0	0	0	0	0	543	(7)=(6)-(5) Diferencia
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0		0	0	0	0	0	0	(7)=(6)-(5) Diferencia
<b>Nen-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>25876</b>		<b>36969</b>	<b>41816</b>	<b>43817</b>	<b>43817</b>	<b>35093</b>	<b>8724</b>	
230	Kapitale të Paturpëzuarra	0		0	1500	1500	1500	0	0	(7)=(6)-(5) Diferencia
231	Kapitale të Trupëzuarra	0		1000	8000	15807	15807	0	1500	(7)=(6)-(5) Diferencia
232	Transfera Kapitale	0		0	0	0	0	0	0	(7)=(6)-(5) Diferencia
<b>Nen-Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>0</b>		<b>1000</b>	<b>9500</b>	<b>17307</b>	<b>17307</b>	<b>0</b>	<b>17307</b>	


230	Kapitale të Patrupëzura	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzura	0	0	0	0	0	0
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0
	<b>Shpenzime</b>						
Nen -Totali	Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0
Totali	Kapitale	0	1000	9500	17307	17307	17307
Totali (korrente + kapitale )		25876	37669	51316	61124	61124	35093
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Liljana Pleqi	Kryetari Njësisë Vëtëqeverisjes Vendore	Emri	Ana	VERUSHI	CAPITAL	CAPITAL
	Firma		Firma				
	Data	13.03.2019	Data	13.03.2019			

KESHILLI QARKUT KORCE

## Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Per perioden vietore 2018

230	Kapitale të Patrupësuarra						0
231	Kapitale të Trupësuarra						0
232	Transferë Kapitale						0
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0	0
Totali (korrente + kapitale )		6499	7058	6770	6840	6840	6310
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri Liljana	Kryetari Njësisë Vëtëqeverisjes Vendore	Emri	Ana	VERUSHI		
Firma			Firma				
Data		13.03.2019	Data	13.03.2019			




**KESHILLI I QARKUT KORCE**

**Anekzi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikuve**

**Per periudhen vjetori 2018**

							<b>ne 000/lleke</b>
<b>Këshilli</b>	<b>KORCE</b>						<b>Kodi i Grupit / Njësisë</b>
<b>Qarkut</b>	<b>Programi</b>						<b>Vendore</b>
<b>Art.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>-1</b> Fakti i vitit paraardhes	<b>-2</b> PBA	<b>-3</b> Buxheti Vjetor	<b>-4</b> Buxheti Vjetor	<b>-5</b> Buxheti Vjetor	<b>Kodi i Programit</b>
		<b>Viti 2017</b>	<b>Plan 2018</b>	<b>Viti Plan Filestar Viti 2018</b>	<b>Plan i Rishkuar Viti 2018</b>	<b>Piani i Periudhes/progresiv</b>	<b>(7)=(6)-(5)</b>
600	Paga	0	0	0	0	0	Diferencia
601	Sigurime Shoqërore	0	0	0	0	0	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjetra	91	19421	37192	45542	69	45473
603	Subvencione	0	0				0
604	Transfera Korente të Brendshme	0	0				0
605	Transfera Korente të Huaja	0	0				0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	0				0
<b>Nen -Totali</b>		<b>Shpenzime Korente</b>	<b>91</b>	<b>19421</b>	<b>37192</b>	<b>45542</b>	<b>45473</b>
230	Kapitale të Parupëzuara	0				69	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0					0
232	Transfera Kapitale	0					0
<b>Nen -Totali</b>		<b>Shpenzime Kapitale me financim të brendshem</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

230	Kapitale të Pattupëzuara						0
231	Kapitale të Trupëzuara						0
232	Transfera Kapitale						0
	<i>Shpenzime financim te huaj</i>						
Nen - Totali		0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime kapitale	0	0	0	0	0	0
Totali (korrente + kapitale )		91	19421	37192	45542	45542	69
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri Lijana Pleqi	Kryetari Njësisë Vjetëqeverisjes Vendore	Emri	Ana	VERUSHKA Srl		
	Firma		Firma				
	Data	13.03.2019	Data	13.03.2019			






**KESHILLI I QARKUT KORCE**

**Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujive**

**Per periudhen vjetore 2018**

ne 000/leka

Këshilli Qarkut		KORCE		Kodi i Grupit / Njësise		Vendore	
Programi		04980		Kodi i Programit		04980	
Art.	Emertimi	-1 Fakti i vittit paraardhes	-2 PBA	-3 Buxheti Vjetor	-4 Buxheti Vjetor	-5 Buxheti Vjetor	-6 Fakti
		Viti 2017	Plan 2018	Viti 2018	Plan Fillestar Viti 2018	Viti 2018	(7)=(6)-(5)
600	Paga	0	0	0	0	0	Diferencia
601	Sigurime Shoqërore	0	0	0	0	0	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	0	1500	500	350	350	350
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0
604	Transfera Korente të Brendshme	0	0	0	0	0	0
605	Transfera Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	0	0	0	0	0
<i>Nen-Totali</i>		<i>Shpenzime Korrante</i>	<i>1500</i>	<i>500</i>	<i>350</i>	<i>350</i>	<i>350</i>
230	Kapitale të Pattupëzullara	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzura	0	0	0	0	0	0
232	Transfera Kapitale	0	0	0	0	0	0
<i>Nen -Totali</i>		<i>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>

230	Kapitale të Patrujëzuarat	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuarat	0	0	0	0	0	0
232	Transferat Kapitale	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0	0
Totali (korrente + kapitale )		0	1500	500	350	200	350
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri Liljana Pleci	Kryetari Njësisë Vjetëqeverisjes Vendore		Emri	Ana	VERUSHI	
	Firma			Firma			
	Data	13.03.2019		Data	13.03.2019	